



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:259953

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05499520

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil Gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditores M.V., nga Gjakova, të cilën e përfaqëson Ylli Bokshi avokat në Gjakovë, kundër debitores së përmbarimit Komunës së Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për përmbarimin e dokumentit të ekzekutueshëm – aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.1815/21, të datës 24.11.2022, i plotfuqishëm me datë 09.12.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 20.12.2022, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në shumë të përgjithshme prej 2,376.49 euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhironlogarisë bankare, jashtë seancës gjyqësore, me datë 25 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.URDHËROHET, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me aktvendimin e kësaj gjykate, 2021:259953 të datës 22.05.2023, për lejimin e përmbarimit të dokumentit të ekzekutueshëm - aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1815/2021, të datës 24.11.2022, i plotfuqishëm me datë 09.12.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 20.12.2022, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, dhe atë - Kreditores M.V., nga Komuna e Gjakovës, ti paguaj në emër të borxhit kryesor shumë prej 1,439.01 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar prej datës 15.11.2021 – 12.03.2024 gjithsej kamata 267.48 euro, dhe shpenzimet të procedurës kontestimore dhe përmbarimore në shumë prej 670.00 euro, respektivisht të gjitha detyrimet në shumë të

përgjithshme prej 2,376.49 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, në atë mënyrë që nga xhirollogaria e debitorës së përmbarimit, Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, t'i barten këto mjetet monetare, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorës, Ylli Bokshi avokat në Gjakovë në xhirollogarinë bankare, "Avokatura Bokshi" SH.P.K. me numër ... në Bankën TEB sh.a.

II. OBLIGOHET, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën t'a njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

A r s y e t i m

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të kreditorës së përmbarimit, me aktvendimin 2021:259953, të datës 22.05.2023, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit. Ndaj këtij aktvendimi, debitorja ka ushtruar prapësim me datë 01.06.2023, ndërsa i autorizuari i kreditorës me datë 01.06.2023 ka paraqitur përgjigje në prapsim. Duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorës, gjykata me aktvendim 2021:259953, të datës 31.10.2023 ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e lartcekur.

Meqenëse pala kreditore në propozimin e saj për përmbarim, ka cekur mjetin e përmbarimit - transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare e me qëllim të realizimit të detyrimit të lartë cekur në të holla dhe se pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret, duhet të bëhet debitimi i mjeteve të lartcekura monetare, t'ia paguaj kreditorës M.V., nga Komuna e Gjakovës, ti paguaj në emër të borxhit kryesor shumë prej 1,439.01 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar prej datës 15.11.2021 – 12.03.2024 gjithsej kamata 267.48 euro, dhe shpenzimet të procedurës kontestimore dhe përmbarimore në shumë prej 670.00 euro, respektivisht të gjitha detyrimet në shumë të përgjithshme prej 2,376.49 euro, përmes bartjes së tyre në xhirollogarinë gjegjëse bankare dhe atë për këtë arsye:

Me shikim në shkresat e lëndës, 2021:259953, kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përmbarimit – aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1815/21, të datës 24.11.2022, i plotfuqishëm me datë 09.12.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 20.12.2022, për shkak të detyrimit në të holla, si në rastin konkret me debitimin e mjeteve financiare përmes xhirollogarisë bankare, sipas nenit 152 të LPP-së, duke u bazuar në dokumentin e lartë cekur të përmbarimit, se debitorja, Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale

e Arsimit, është e obliguar që kreditores së përmbarimit, ti paguaj shumat e lartcekura të gjitha në afat prej 7 ditësh, andaj në arsyet e cekura më lartë kjo gjykatë, vendosi që të urdhëroj Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prandaj, gjykata duke u bazuar në nenit 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

2021:259953, më 25 mars 2024

GJYQTAR,

Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e veçantë.